

## MODELI PËR DOKUMENTIN KONSULTATIV

Për draftin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar” :

**Subjektet raportuese :** a) shoqëritë më përgjegjësi të kufizuar;  
b) shoqëritë aksionare;  
c) shoqëritë kolektive;  
ç) shoqëritë komandite;  
d) zyrat e përfaqësimit dhe degët e shoqërive të huaja; dh) shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre;  
e) shoqëritë e bashkëpunimit të ndërsjellë;  
ë) shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor;  
f) çdo subjekt tjetër juridik, i cili me ligj detyrohet të regjistrohet pranë QKB-së;  
g) organizatat jofitimprurëse, ku përfshihen fondacionet, shoqatat, qendrat, si dhe degët e organizatave jofitimprurëse të huaja, të regjistruara në regjistrin e organizatave jofitimprurëse në Republikën e Shqipërisë;  
gj) personat juridikë dhe ndërmarrjet, aksionarët e të cilëve, përveç institucioneve qendrore dhe/ose vendore të Republikës së Shqipërisë, janë edhe individë/persona juridikë të tjerë shqiptarë dhe/ose të huaj.)

**Autoritetet kompetente shtetërore:** a) Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave;  
b) Banka e Shqipërisë;  
c) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;  
ç) Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;  
d) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;  
dh) Prokuroria;  
e) Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK))

**Subjektet e detyruara:** avokatë; noterë; financierë, kontabilistë, etj)

**Dhomat e Tregtisë**

Kohëzgjatja e konsultimeve:

2 -22 dhjetor 2021

Si të përgjigjeni:

Me anë të emailit : [Saimir.Mucmataj@financa.gov.al](mailto:Saimir.Mucmataj@financa.gov.al)

Kontakti:

[Megi.Melani@financa.gov.al](mailto:Megi.Melani@financa.gov.al) dhe [Saimir.Mucmataj@financa.gov.al](mailto:Saimir.Mucmataj@financa.gov.al)

Datat dhe vendet e takimeve publike:

*Nuk do të ketë takime publike*

Sfondi i propozimit legjislativ:

Me miratimin e ligjit nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar, të gjitha subjektet raportuese të regjistruara në Republikën e Shqipërisë kanë detyrimin e regjistrimit të pronarëve përfitues në Regjistrin e Pronarëve Përfitues. Gjithashtu, ky ligj parashikoi se subjektet raportuese ekzistuese duhet të regjistrojnë të dhënat e pronarëve të tyre përfitues deri më datë 30.06.2021 (afat i shtyrë me anë të Aktit Normativ nr.12, datë 25.03.2021, miratuar me ligjin nr.55/2021). Ndërkohë, që bazuar në këtë ligj subjektet raportuese të krijuara rishtazi kanë detyrimin të regjistrojnë pronarët e tyre përfitues brenda 30 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të subjekteve raportuese, në rastin e regjistrimit fillestar të pronarëve përfitues.

Megjithatë, nga analizimi i të dhënave të regjistruara në Regjistrin e Pronarëve Përfitues, rezulton se nga 59165 subjekte raportuese ekzistuese të regjistruara në Regjistrin Tregtar përpara datës së krijimit të Regjistrit të Pronarëve Përfitues, prej të cilëve 8689 subjekte me statusin pezulluar, bazuar në VKM nr.273/2021 kanë detyrimin të regjistrojnë pronarin përfitues në regjistrin e pronarit përfitues, përpara kërkesës për ndryshimin e statusit të tyre në regjistrin tregtar, vetëm 21460 subjekte raportuese ekzistuese kanë regjistruar të dhënat e pronarëve të tyre përfitues në regjistër deri më datë 10.11.2021.

Gjithashtu, nga 4861 Organizata Jofitimprurëse ekzistuese të regjistruara në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, vetëm 1961 Organizata Jofitimprurëse kanë regjistruar të dhënat e pronarëve të tyre përfitues në regjistër.

Ndërkohë, nga analiza e bërë rezulton se nga 2869 subjekte raportuese të krijuara rishtazi pas krijimit të Regjistrit të Pronarëve Përfitues (gjatë periudhës kohore 01.02.2021-10.11.2021), vetëm 1972 subjekte kanë regjistruar të dhënat e pronarëve të tyre përfitues në regjistër brenda 30 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të tyre në regjistrin tregtar.

Me qëllim rregullimin e kësaj situate dhe zbatimin e rekomandimeve të ekspertëve të MONEYVAL, të cilët kërkojnë që Shqipëria të krijojë mekanizma që të sigurojnë një numër sa më të lartë të subjekteve raportuese që regjistrojnë të dhënat e pronarëve të tyre përfitues, u vlerësua ndërmarrja e disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin ekzistues nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar.

## Propozimet

Projektligji synon të nxisë rritjen e numrit e raportimeve të pronarëve përfitues, si dhe zbatimin e rekomandimeve të ekspertëve të MONEYVAL, të cilët kërkojnë që Shqipëria të krijojë mekanizma për sigurimin e një numri sa më të lartë të subjekteve raportuese që regjistrojnë të dhënat e pronarëve të tyre përfitues, u vlerësua ndërmarrja e disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin ekzistues nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar.

Më konkretisht, ky projektligj parashikon ndryshimet si më poshtë:

- mundësinë e popullimit automatik të regjistrimit të pronarëve përfitues nga Qendra Kombëtare e Biznesit për subjektet raportuese që kanë pronësi direkte, duke ju referuar gjendjes së ortakërisë të regjistruar në regjistrin tregtar për subjektet raportuese me pronësi direkte.
- shtyrjen e afatit për raportimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese ekzistuese me pronësi indirekte të regjistruara në Regjistrin Tregtar dhe nga Organizatat Jofitimprurëse, deri më datë 01.04.2022.
- shtyrjen e afatit për raportimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese që regjistrohen rishtazi, nga brenda 30 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të subjekteve raportuese, në brenda 40 ditëve kalendarike nga data e regjistrimit të subjekteve raportuese. Kjo shtyrje afati është bërë për arsye se aktualisht koha për t’u pajisur me nënshkrim elektronik, është 7-10 ditë, dhe kjo gjë krijon pengesa dhe vonesa për subjektet raportuese për regjistrimin e të dhënave të pronarëve të tyre përfitues në regjistër.
- faljen e gjobave të vendosura nga QKB-ja përpara hyrjes në fuqi të projektligjit, në lidhje me mos përmbushjen e detyrimit për raportimin fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese, me kusht që raportimi të kryhet prej tyre deri më datë 01.04.2022.
- përshkallëzimin e masës së kundërvajtjeve administrative që do të vendosen në vijim të hyrjes në fuqi të projektligjit, mbi bazën e vonesës në përmbushjen e detyrimit të raportimit fillestar të pronarëve përfitues nga subjektet raportuese që regjistrohen rishtazi. Ky përshkallëzim bëhet me qëllim mundësimin e rritjes së numrit të subjekteve raportuese që regjistrojnë të dhënat e pronarëve të tyre përfitues në regjistër.
- parashikimin e procedurës së pezullimit të aplikimit për një afat 30 ditor, në rast të aplikimeve të paplota. Kjo risi u mundëson subjekteve raportuese të rregullojnë të metat e konstatuara në aplikim gjatë afatit të pezullimit dhe të regjistrojnë të dhënat e pronarëve të tyre përfitues, si dhe të evitojnë marrjen e gjobave.
- heqjen e gjobës për administratorin në rastin e mosregjistrimit të të dhënave të pronarëve përfitues të subjekteve raportuese brenda afatit ligjor, dhe përfshirja e

vlerës së kësaj gjobe në gjobat e vendosura ndaj subjekteve raportuese, duke mundësuar vjeljen e kësaj shume nga subjektit raportues. Ky ndryshim është parë i arsyeshëm për t'u bërë për arsye se aktualisht, QKB-ja e ka të pamundur të vjelë nga përfaqësuesi ligjor, kundërvajtjet administrative të vendosura, pasi e vetmja mënyrë për vjeljen e gjobave është ndërprerja e shërbimeve për subjektin raportues.

- lejimi i ofrimit të shërbimit të ndryshimit/riemërimit të administratorit ose të përfaqësuesit ligjor të subjekteve raportuese në rastet kur ndaj subjekteve raportuese është vendosur gjobë dhe është ndërprerë shërbimi në regjistrin tregtar dhe në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse. Ky parashikim është bërë pasi parashikimi aktual ligjor krijon problematika të shumta duke qenë se subjektet raportues e kanë të pamundur të emërojnë një përfaqësues të ri për të përmbushuri detyrimet e raportimit, pasi ato nuk marrin shërbim nga regjistrin tregtar ose në regjistrin e organizatave jofitimprurëse për arsye se ato nuk kanë regjistruar pronarët e tyre përfitues brenda afateve ligjore.

### Pyetjet

Nuk ka pyetje specifike

## PËRGATITJA E PLANIT TË KONSULTIMIT

1. Emri i ligjit/politikës të propozuar: “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues”, i ndryshuar”

2. Audiencia e synuar, lloji i konsultimeve (paraprake/k. për projekt-ligjet), metodat e konsultimit, kanali i komunikimit për shkëmbimin e informacionit

<b>Audiencia e synuar</b>	<b>Lloji i konsultimeve:</b> (1) konsultime paraprake, (2) konsultime për projektligjet	<b>Metodat e konsultimit</b> <i>(e-konsultimi, takimet publike, seminare, sondazhe etj.)</i>	Kanali i komunikimit për shkëmbimin e informacionit dhe ftesave <i>(email, rrjetet sociale, etj.)</i>
<b>Komente të përgjithshme publike, sidomos nga palët që janë pjesë e ligjit nr.112/2020</b>	<b>Konsultime për projektligjet</b>	<b>Nuk është menduar të organizohen takime publike, seminare sondazhe</b>	<b>Me postë elektronike</b>

3. Afati kohor i aktiviteteve të konsultimit (nga fillimi deri në raportim)

20 ditë kalendarike

4. Burimet e nevojshme

- Burime njerëzore të nevojshme: **Jo**
- Burime Financiare të nevojshme: **Jo**

## 5. Mbledhja e përgjigjeve

Përgjigjet mblidhen me postë elektronike

## 6. Monitorimi i procesit

*Kjo matricë mund t'ju ndihmojë në monitorimin e vazhdueshëm pasi përfshin treguesit dhe metodat më të zakonshme për matjen e nivelit të suksesit të proceseve të konsultimit. Në fazën e planifikimit, ju duhet të përcaktoni vlerën e planifikuar të treguesve sasiore dhe metodave/mjeteve që do të përdorni për matjen e suksesit gjatë dhe në përfundim të procesit.*

Treguesit dhe metodat për monitorimin e procesit					
Korniza e procesit		Përshtatshmëria	Masat për përmirësime (deklaroni, si do të përmirësoni procesin e pjesëmarrjes)		
A u realizuan aktivitetet sipas afatit të planifikuar?		<input type="checkbox"/> jo			
A u realizuan aktivitetet sipas burimeve financiare të planifikuara?		<input type="checkbox"/> jo			
A u realizuan aktivitetet sipas burimeve njerëzore të planifikuara?		<input type="checkbox"/> jo			
Treguesit sasiore					
Treguesit sasiore (deklaroni treguesit për monitorim)	Vlerat e planifikuara (deklaroni treguesit për vlerat)	Vlerat arritura (deklaroni vlerën e arritur)	e	Përshtatshmëria	Masat për përmirësime (deklaroni si do të përmirësoni performancën)
(plotësojeni gjatë fazës së planifikimit të procesit)			(plotësojeni gjatë monitorimit)		

<input type="checkbox"/> numri i metodave të konsultimit			<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo	
<input type="checkbox"/> numri i palëve të përfshira			<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo	
<input type="checkbox"/> numri i pjesëmarrësve			<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo	
<input type="checkbox"/> numri i komenteve pranuar	0		<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo	
<input type="checkbox"/> tjetër:			<input type="checkbox"/> po <input type="checkbox"/> jo	
<b>Mjetet për matjen e treguesve</b>				
<input type="checkbox"/> lista e pjesëmarrësve <input type="checkbox"/> raportimi i aktivitetit <input type="checkbox"/> raporti i reagimeve <input type="checkbox"/> lista e komenteve të marra <input type="checkbox"/> tjetër:				
<b>Treguesit cilësorë</b>				
Treguesit cilësorë (zgjidhni treguesit cilësorë - merrni parasysh objektivat e procesit të pjesëmarrjes)		Gjetjet (deklaroni gjetjet)		Masat për përmirësime (deklaroni si do të përmirësoni performancën)
<input type="checkbox"/> cilësia e metodave të konsultimit				
<input type="checkbox"/> përmbushja e pritshmërive të pjesëmarrësve				

<input type="checkbox"/> cilësia e komenteve dhe kontributeve të mara		
<input type="checkbox"/> treguesit sipas objektivave të procesit:		
Mjetet për matjen e treguesve		
<input type="checkbox"/> pyetësi i vlerësimit <input type="checkbox"/> diskutimi joformal me pjesëmarrësit <input type="checkbox"/> regjistrimi i pikëpamjeve të pjesëmarrësve <input type="checkbox"/> raportimi i aktivitetit <input type="checkbox"/> tjetër:		